



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE

2025 - 2027

KOMUNA E VUSHTRRIË

Përmbajtja

- I. Hyrje
- II. Deklarata e prioriteteve afatmesme
- III. Vizioni i komunës
- IV. Misioni i komunës
- V. Korniza fiskale komunale
- VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2025-2027
- VII. Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët
- VIII. Analiza gjinore
- IX. Informacionet sipas programeve

I. Hyrje

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2025. Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025 dhe orientimet për vitet 2026-2027, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2025 si dhe parashikimin afatmesëm 2026-2027. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP). Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte: - Buxheti në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël, - Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës, - Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe - Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Projektet kapitale shumëvjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë.

Fazat e përmbledhura të KAB-it Komunal dhe afatet kohore



KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

II. Deklarata e prioriteteve afatmesme

Bazuar në nevojat momentale të popullatës, resurset në dispozicion dhe përvoja, Komuna e Vushtrrisë është e pozicionuar për të gjeneruar një strategji të re zhvillimore që synon në përsosjen e strukturës së saj ekonomike, rritjen e punësimit, dhe krijimin e një ambienti për përshejtimin e përgjithshëm të zhvillimit lokal, prodhimtarisë, bujqësi moderne dhe turizëm. Kjo strategji e re e zhvillimit ekonomik siguron një vizion për Komunën e cila përfshinë synimet specifike për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe ato të mesme (NVM) dhe të bujqësisë, si dhe programet dhe projektet për ti realizuar këto synime. Komuna e Vushtrrisë ka një shtrirje të bizneseve shumë të sukseshme dhe aktive në tregun e Kosovës dhe tregun e jashtëm që e ushtrojnë aktivitetin afarist. Në të vërtetë, Komuna e Vushtrrisë tanimë është duke punuar për të përsosur ambientin për biznes duke punuar në finalizimin e Zonave Ekonomike si zona komerciale, artizanale dhe prodhuese, duke përfshirë këtu bizneset e mëdha dhe të vogla, ndërmarrësit dhe organizatat aktive në Komunë kanë bërë një ndryshim në mendimin rreth zhvillimit ekonomik si rezultat i pjesëmarrjes në këtë qasje të zhvillimit komunal. Këto synimet kërkojnë një riorganizim të konsiderueshëm, ndryshim në proceset e punës në institucionet e qeverisjes lokale, krijimin e mekanizmave të rinj për bashkëpunim ndërmes sektorit publik dhe privat, dhe formimi dhe ndërtimi i kapacitetit të institucioneve dhe organizatave të reja që do të marrin përgjegjësinë për zhvillim ekonomik. Për të përmbushur këto synime ambicioze, Komuna e Vushtrrisë duhet të mobilizojë dhe angazhojë të gjitha resurset që janë në dispozicion, të cilat resurse qartazi do të jenë të pamjaftueshme për implementimin e tërë planit. Si rrjedhim, Komuna do të kërkojë përkrahje domethënëse nga nivelet tjera të qeverisjes në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare në formë të diturisë, përvojës, dhe ndihmës teknike dhe financiare për të transformuar vizionet dhe synimet e saja në realitet brenda periudhës më të shkurtër kohore të mundshme.

PRIORITETET E QEVERISË PËR PERIUdhËN BUXHETORE 2025-2027

Prioritetet e mëposhtme për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027 janë paraqitur në mënyrë specifike të strukturuar sipas shtyllave të Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillim, dhe sipas sektorëve të politikave po ashtu të definuara në kornizën strategjike. Prioritetet dhe drejtimet kryesore për zbatimin e tyre janë hartuar duke u bazuar në propozimet e ministrive të linjës që rrjedhin nga SKZH dhe strategjitë tjera sektoriale.

Duke u bazuar në këtë, organizatat buxhetore gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2025 me parashikimet për periudhën afatmesme (2025-2027), pritët të tregojnë se si plani i tyre buxhetor i përgjigjet prioriteteve të qeverisë të paraqitura më poshtë. Kundrejt prioriteteve të dhëna, organizatat buxhetore inkurajohen që të përmirësojnë efikasitetin në shpenzime përmes rialokimit brenda kufijve ekzistues.

- ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK
- ZHVILLIM I BARABARTË NJERËZOR
- SIGURIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

Pozita gjeografike e Komunës së Vushtrrisë

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:

X1 : 200 50' 09'' dhe X2 : 210 07' 05'';

Y1 : 420 42' 20'' dhe Y2 : 420 55' 12''.

Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me sipërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km². Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vushtrrisë ka 69870 banorë të organizuar në 11866 ekonomi familjare.

Gjendja aktuale në ekonomi

Bizneset aktive të Komunës së Vushtrrisë llogaritet të jenë 4 172. Në kohën e fundit vërehet një trend pozitiv në rritjen e industrisë përpunuese- prodhuese. Prej këtyre bizneseve kryesisht dominon industrisë përpunuese- prodhuese, pastaj bizneset shërbyese, tregtia e kështu me radhë (Shih tabelën më poshtë). Këto subjekte ekonomike punësojnë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve. Bazuar në të dhënat e Zyrës për regjistrim të bizneseve në komunë të cilat janë marrë në ARBK, nga bizneset të cilat operojnë në Komunën e Vushtrrisë, një pjesë e konsiderueshme e tyre merren me veprimtari tregtare 20% , në sektorin e shërbimeve (hotele dhe restorante) 5.66% , industri përpunuese 21% etj. Krahasuar me vitin e kaluar vërehet një rritje e lehtë në përqindjen e industrisë përpunuese.

Struktura e veprimtarive ekonomike bazuar në të dhënat e marra nga ARBK

	Vushtrri
A - BUJQËSIA, PYLLTARIA DHE PESHKIMI	156
B - MINIERAT DHE GURORET (INDUSTRIA NXJERRËSE)	2
E - FURNIZIMI ME UJË; KANALIZIMI, AKTIVITETET E MENAXHIMIT DHE TË TRAJTIMIT TË MBETURINAVE	14
F - NDËRTIMTARIA	274
H - TRANSPORTI DHE MAGAZINIMI	151
I - AKOMODIMI DHE SHËRBIMI USHQIMOR	233
J - INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI	94
K - AKTIVITETET FINANCIARE DHE TË SIGURIMIT	20
L - AKTIVITETET E PATUNDSHMËRISË	17
M - AKTIVITETET PROFESIONALE, SHKENCORE DHE TEKNIKE	205

N - SHËRBIMET ADMINISTRATIVE DHE MBËSHTETËSE	189
O - ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MBROJTJA; SIGURIMI SOCIAL I DETYRUESHËM	8
P - ARSIMI	75
Q - AKTIVITETET E SHËNDETIT TË NJERIUT DHE TË PUNËS SOCIALE	120
R - ARTET, ARGËTIMI DHE REKREACIONI	59
S - AKTIVITETET E TJERA SHËRBYESE	849
G - TREGTIA ME SHUMICË DHE PAKICË; RIPARIMI I MJETEVE MOTORIKE DHE MOTOÇIKLETAVE	820
D - FURNIZIMI ME RRYMË, GAZ, AVULL DHE AJËR TË KONDICIONUAR	8
C - INDUSTRIA PËRPUNUESE	878
Grand Total	4,172

Burimet natyrore

Komuna e Vushtrrisë është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Kompleksi i maleve të Çyqavicës është i pasur me florë dhe faunë të zhvilluar si dhe me reliev karakteristik të llojit të veçantë. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojllojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastudiara sa duhet. Komuna e Vushtrrisë, përveç të tjerash, është e krahasuar edhe me shumë vende me potenciale të mineraleve dhe mundësive për eksploitime druri dhe guri, si:

- Duboc - magnezit e porcelan;
- Bivolak, Zhilivodë, Beçuk, Stroc, Gllavatin - thëngjill druri
- Pasomë, Tërllobuq, Smrekonicë dhe Shalë - eksploatimi i gurit
- Gumnishtë dhe Boshlan - pasuri të plumbit dhe zinkut
- Bajnskë - ujë termo-mineral
- Gjelbishtë dhe Gojbulë - ujë mineral
- Karaçë - burime minerale

III.Vizioni i komunës

Komuna e Vushtrrisë është mjedis i përshtatshëm për ndërmarrësi dhe ka ndërtuar strukturë funksionale ndërlidhëse ndërmjet sektorëve të bujqësisë, blegtorisë, edukimit dhe ndërmarrësisë. Vushtrria apo “Vicianum” është “shtëpi” e bizneseve dhe është identifikim i qendrës së dikurshme historike dhe tregtare.

VI. Misioni i Komunës

Si zonë e veçantë historike do të marrë identitetin e saj të dikurshëm si qendër për bizneset prodhuese dhe aktivitetet tjera të biznesit duke rritë mirëqenien ekonomike dhe sociale për të gjithë qytetarët e saj. Zhvillimi ekonomik lokal do të arrihet si bashkëveprim i zhvillimit të ambientit

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

biznesor, prodhimtarisë dhe kulturave bujqësore, me sistem arsimor të harmonizuar me ekonominë lokale duke siguruar standard të mirëqenë jetësor dhe social. Administrata komunale do të jetë në shërbim të plotë të qytetarëve dhe bashkëpunëtor I akterëve të ekonomisë lokale.

Bazuar në dokumentet strategjike, Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të Qeverisë së Kosovës dhe prioriteteve bazë të saj, si dhe Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/01 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për tri vitet e ardhshme. Synimi i Komunës së Vushtrrisë është që të jetë qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, e integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit, jetës sportive dhe synon një kualitet më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

SYNIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Si rezultat i hulumtimit dhe analizimit të saj, Komuna ka identifikuar aftësitë për të krijuar ndërmarrjet si një forcë që mund të jetë çelës për të krijuar ndërmarrje të reja, zhvilloj ato ekzistuese, dhe të inkurajoj krijimin e vendeve të punës. Gjatë zhvillimit të aftësive për të krijuar ndërmarrjet, Vushtrria duhet gradualisht ta ringjallë administratën komunale në shërbim të bizneseve, e cila do të kontribuojnë për një kualitet më të mirë të jetës për qytetarët e saj. Komuna do të përpiqet të zhvilloj sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe të kulturës me qëllim që të transformojë Komunën e Vushtrrisë në një qendër dinamike të ndërmarrjeve. Gjatë procesit të punëtorisë (intervistave), janë anë shqyrtuar ide të programeve për arritjen e këtyre synimeve strategjike. Idetë e propozuara ishin vlerësuar si dhe janë prezantuar këto konkluzione. Vazhdimi i procesit kërkon analizim më të thellë për të siguruar se projekt propozime kualitative do të rezantohen te akterët lokal dhe tek komuniteti i donatorëve. Objektivat për secilin synim strategjik gjithashtu janë prezantuar. Këto qëllime janë konturuar nga nën-grupet dhe pastaj janë vlerësuar. Si rezultat, Komuna ishte në gjendje të identifikojë tri projektet me prioritet të lartë për secilën synim të saj.

SYNIMI STRATEGJIK 1- Klimë biznesore të përshtatshme për biznese ekzistuese dhe tërheqjen e investimeve të jashtme në me fokus në prodhim

1. Përkrahja e prodhuesve
2. Krijimi i qendrës për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe mekanizmave të organizimit të biznesit
3. Krijimi i zonave të reja për investime, kapacitete për mbështetje të biznesit dhe përdorimi i kapitalit ekzistues të komunës
4. Rregulloret komunale për stimulimin e biznesit dhe krijimi i fondeve për përkrahjen e bizneseve

SYNIMI STRATEGJIK 2- Bujqësi moderne me produkte kualitative industriale dhe të konsumit direkt për tregun lokal,

1. Krijimi i Oazave Bujqësore (koperativave bashkëkohore)
2. Mbrojtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore
3. Mundësimi i aplikimit të teknikave dhe teknologjive moderne bujqësore
4. Sigurojë përgatitje profesionale dhe stimulim të bujqësisë

SYNIMI STRATEGJIK 3 - Ngritja e kualitetit të jetës kulturore dhe zhvillimit të turizmit

1. Vushtrria qendër historike
2. Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe sportiv

Aktivizimi i zonës aktuale

Komuna e Vushtrisë është në ndërtim e sipër të zonës industriale me sipërfaqë rreth 14 ha. Përderisa kjo zonë është në proces Komuna e Vushtrisë, specifikisht Drejtoria për zhvillim ekonomik dhe bujqësi mund të filloj me ndërtimin e kapaciteteve teknike për menaxhimin e zonës dhe tërheqjen e investitorëve. Duke u bazuar në studimin e fizibilitetit të zonës, fillimisht mund të targetohen bizneset që do të alokohen në zonë. Është shumë e rëndësishme që bizneset ekzistuese të konsultohen fillimisht për nevojat dhe kapacitetet e tyre për vendosjen në zone industriale duke pas parasysh që ato janë bartëse të nivelit të deritashëm i zhvillimit ekonomik lokal.

Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

- Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta.
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile.

Përmirësimi i ambientit të komunës dhe qëndrueshmëria e tij

- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi), transporti dhe kanalizimi;
- Përmirësimi i standardeve ambientale;
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara.

Ndërsa prioriteti i fundit strategjik i komunës ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

Qeveri komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në qasjen më të afërt dhe të lehtë të tyre në administratë përmes fushave prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2025-2027 do të shoqërohen me shuma të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike, të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

Kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit 2025 - 2027

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Procesi buxhetor për vitet 2025-2027 ka për qëllim ndërlidhjen e planeve dhe politikave buxhetore të qeverisë me nevojat ekonomike dhe sociale të vendit. Gjatë hartimit të këtij dokumenti duhet t'i japim prioritet:

- Projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e objektivave të përcaktuara me dokumentet strategjike.
- Projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake;
- Të përfshijmë brenda ndarjeve buxhetore obligimet për financim të projekteve me bashkëfinancim të jashtëm;
- Të kujdesemi që të hyjmë në obligim për bashkëfinancim vetëm deri në nivelin që lejon korniza buxhetore;

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxheti në nivel të programeve dhe nënprogrameve në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës;
- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2025 dhe projeksionet për vitet 2026 – 2027;

Planifikimi i projekteve në pajtim me UA MF NR.04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe shpenzimet e shpronësimit. Organizatat buxhetore, pas një analize paraprake, duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit për çdo projekt individual në kuadër të kostos totale të projektit, e jo të planifikojnë linjë të veçantë për shpronësim.

Planifikimi i projekteve në pajtim me Udhëzim Administrativ Mf- Nr. 06/2019 Për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritetizimin e Projekteve Kapitale. Kriteret e përzgjedhjes sipas këtij UA janë:

1.1.Përputhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 si dhe me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal.

Parimet themelore

Procesi i përgatitjes së parashikimit të shpenzimeve (kufijve buxhetorë) për periudhën 2025-2027, është parakusht për rritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësim të mjedisit brenda të cilit zhvillohen aktivitetet e shtuara të sektorit privat, nxitje të punësimit të qëndrueshëm si dhe mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët. E gjithë kjo do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Përputhje me politikave prioritare të Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH), Planit Kombëtar për Zhvillim (PKZH), Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2023-2025, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe Programin e Qeverisë 2021-2025.

- Alokimin e shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave të politikave të Qeverisë;

- Rritje të cilësisë dhe besueshmërisë në procesin buxhetor si dhe ndërlidhje më të mirë ndërmjet politikave dhe buxhetit.

- Ekzekutim më të lartë të shpenzimeve në krahasim me planifikimin e tyre, me theks të veçantë në shpenzimet kapitale, duke realizuar synimet specifike prioritare.

- Ndërlidhjen me financimin e jashtëm të ofruar nëpërmjet IPA dhe kanaleve të tjera.

V.Korniza fiskale

Parashikimi i të hyrave

Bazuar në projeksionet makroekonomike, të hyrat priten të vazhdojnë të rriten edhe në periudhën afatmesme (2025-27) me një normë mesatare prej 6.0%. Si pjesëmarrje në BPV, të hyrat priten ta mbajnë nivelin e njëjtë me vitin 2023 prej 29.5%.

Sa i përket strukturës së të hyrave, tatimet indirekte priten të përfaqësojnë më shumë se dy të tretat e të hyrave totale në periudhën afatmesme, për t'u ndjekur nga të hyrat nga tatimet direkte me një pjesëmarrje prej rreth 17.8%; dhe të hyrat jo-tatimore me pjesëmarrje rreth 9.8% të të hyrave totale

(Grafiku 7).

Tatime direkte priten të rriten në periudhën afatmesme me një normë mesatare prej 6.5%. Kjo rritje

pritet të reflektohet në rritjen e tatimit në të ardhura të korporatave dhe në tatimin në të ardhura personale me një normë mesatare prej 6.3% dhe 7.2%, respektivisht. Tatimi në pronë priten të shënojnë rritje me rreth 4.1% në periudhën afatmesme.

Të hyrat nga tatimet indirekte priten të vazhdojnë të rriten edhe në periudhën afatmesme me një normë mesatare prej 6.0%. TVSH-ja, që ka pjesëmarrjen më të lartë në të hyrat indirekte, priten të rritet mesatarisht me 6.6% në periudhën afatmesme, kryesisht për shkak të rritjes së importit të mallrave dhe konsumit të përgjithshëm. Të hyrat nga akciza parashihen të kenë rritje mesatare prej 4.3% në periudhën afatmesme, ndërsa të hyrat nga detyrimi doganor priten të rriten mesatarisht me 6.8%.

Të hyrat jo-tatimore parashihet të kenë një rritje mesatare prej 5.8% në periudhën afatmesme. Përderisa të hyrat jo-tatimore të nivelit qendror priten të rriten mesatarisht 5.2%, ato të nivelit lokal

pritet të rriten për 11.5%.

Parashikimi i shpenzimeve për periudhën 2025-2027

Në periudhën afatmesme shpenzimet buxhetore pritet të kenë një rritje më të ulët se ajo e viteve paraprake. Gjatë periudhës afatmesme 2025-2027, shpenzimet janë planifikuar të rriten mesatarisht me rreth 5.0%.

Gjatë periudhës afatmesme, shpenzimet rrjedhëse pritet të kenë një rritje mesatare prej 5.5%.

Gjatë viteve 2025-2027, kategoria e shpenzimeve rrjedhëse për paga dhe shtesa planifikohet të ketë një rritje mesatare prej rreth 6.1%. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë një rritje prej 2.4% ndërsa subvencionet dhe transferet pritet të rriten mesatarisht me rreth 6.8%.

Investimet kapitale përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 25.7% të shpenzimeve totale.

Përshkrimi	2024	2025	2026	2027 (vlerësim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	4.3	4.2	4.2	4.1
Inflacioni në %	2.4	2.2	2.0	2.0
BPV për kokë banori, në euro	10,253	10,901	11,653	12,255
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e komunës	74,115	74,352	74,589	74,752
Numri i bizneseve të regjistruara	4,172	4,284	4,890	5,283
Numri i nxënësve	12,796	12,000	11,900	11,850

Granti i Përgjithshëm

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Bazuar në Tabelën 1, të paraqitur në vijim, të përgatitur nga Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me LFPL, Granti i Përgjithshëm për komuna për vitin 2025 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL. Sipas këtij neni, 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore ju ndahen komunave, duke përfshirë mbështetjen buxhetore dhe grantet, grantet e përcaktuara të donatorëve, të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga interesi si dhe taksat, ngarkesat dhe të tjera nga qeveria lokale.

Siç paraqitet në tabelën në vijim, bazuar në vlerësimet të Departamentit të Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar, të hyrat e përgjithshme qeveritare për vitin 2025 pritet të jenë 2,985.32 mil. euro. Nga kjo shumë, zbriten ato të hyra siç specifikohet në nenin 24 të LFPL dhe vijmë tek baza për ndarjen e grantit të përgjithshëm për komuna, i cili grant për vitin 2025 do të jetë në shumë prej 284.68 milion euro.

Përshkrimi	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
A. Të hyrat e përgjithshme të Qeverisë	2,985.32	3,227.19	3,413.61	3,603.46
Mbeshtetja buxhetore dhe grante	-18.0	-22.5	-22.5	-22.5
Tatimi në pronë	-49.3	-45.0	-50.0	-55.0
Grantet e përcaktuara të donatorëve	-12.00	-12.00	-12.00	-12.00
Taksa ngarkesa dhe të tjera nga Qeveria Lokale	-56.2	-70.0	-73.5	-77.2
Të hyrat nga interesi	-3.0	-2.8	-2.5	-2.2
B. Baza për llogaritjen e grantit të përgjithshëm për komuna	2,846.80	3,074.89	3,253.11	3,434.58
C. Granti i përgjithshëm për komuna (10%)	284.68	307.49	325.31	343.46

Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

Sipas këtyre kritereve, Komunës së Vushtrisë i takon:

Shumë fikse prej 140,000 €, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori.	70,130.00 €
Numri i popullsisë (89%)	10,614,956.00€
Shuma për madhësi gjeografike (6%)	577,227.00 €
Shuma për popullsi pakicë në komunë (3%)	81,083.00€
	11,343,396.00€

Granti specifik për Arsim parauniversitar

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASHTI për vitin 2025-2027.

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Grantin specifik për arsim para universitar për vitin 2025 është aprovuar në shumë prej 249.1 milion euro si vijon:

- Paga dhe shtesa në shumë prej 233.8 milion euro,
- Mallra dhe shërbime në shumë prej 13.1 milion euro,
- Shpenzime kapitale në shumë prej 2.2 milion euro.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kritere:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2023/2024;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- j) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- k) Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
 - l) Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafilllore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- o) Kapitallet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- p) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta;
- q) Praktika profesionale;
- r) Kosto e pagesës së procedurave për validim dhe akreditim për shkollat e mesme të larta profesionale (8 Shkolla);
- s) Këshilltarë të karrierës me bazë në shkollë klasa 6 deri 9;
- t) Specialist të IT-së.
- u) Pagesa e shpenzimeve për shujtën ditore për nxënësit nga klasat 0-5.

Sipas MASHTI-të është raportuar numri për 4,180 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e arsimit para-universitar.

Bazuar në kriteret e shënuara më lartë, Komunës së Vushtrrisë i takon grant për Arsimin parauniversitar në shumë prej 9,861,291.00 € , kjo shumë nuk i mjafton për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e arsimit, por arsimi ndihmohet nga granti i përgjithshëm.

Edhe pse është investuar në masë të konsiderueshme në objekte shkollore edhe më tej gjendja në nuk është e nivelit që kërkohet, prandaj kërkohen investime. Projektet të cilat planifikohen të zhvillohen për periudhën 2025-2027 janë të paraqitura në tabelën më poshtë.

Arsimi			
Projekti	2025	2026	2027
Ndërtimi I shkollave	700,000.00	600,000.00	600,000.00
Meremetim I shkollave	230,000.00	170,000.00	120,000.00
Teknologji informative	180,000.00	140,000.00	140,000.00
Rregullimi I ngrohjeve qendrore	70,000.00	40,000.00	40,000.00
Fusha sportive	90,000.00	60,000.00	60,000.00
Objekte ndihmese	30,000.00	30,000.00	30,000.00
Rrethoja	80,000.00	60,000.00	60,000.00
Rregullimi I oborreve	60,000.00	50,000.00	50,000.00
Kabinete për shkolla	140,000.00	70,000.00	70,000.00
Inventar	100,000.00	100,000.00	100,000.00
	1,680,000.00	1,320,000.00	1,270,000.00

1.4. Granti specifik për Shëndetësi primare

Granti Specifik për shëndetësi primare sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e shëndetësisë primare të MSH për vitin 2025-2027.

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2025 është aprovuar në shumë prej 83 milion euro, si në vijim:

- Kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e shëndetësisë në shume prej 60.3 milion euro,
- Koston për vizitë dhe shërbim në shume prej 14.23 milion euro.
- Vizitat në shtëpi për shtatzëna dhe fëmijë në shumë prej 2.13 milion euro (politik në vazhdimësi),
- Vizitat e kujdesit paliativ në shumë prej 2.1 milion euro (politik në vazhdimësi),
- Shpenzime tjera operative në mallra dhe shërbime në shumë prej 2.1 milion euro
- Shpenzime komunale në shumë prej 2.1 milion euro.

Me Qarkoren Buxhetore Komunale 2025/02 do të bëhet rishikimi dhe harmonizimi i stafit në sektorin e shëndetësisë primare.

Komisioni i granteve, bazuar në kriteret e lartpërmendura Komunës së Vushtrrisë i është ndarë buxhet në vlerë prej 2,732,608.00€. Shuma e ndarë për shëndetësi për vitin 2025 është më e ulët për 526,645.00€. Qeveria komunale me komisionin e granteve është në angazhime për korrigjimin e kësaj zbritje.

Financimi për shërbimet rezidenciale për vitin 2025

Financimi i shërbimeve rezidenciale për shtëpitë e komunitetit për personat e moshuar dhe shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara për vitin 2025 do të jetë në shumë prej 3.5 milion euro.

Për Komunën e Vushtrisë për financimin e shërbimeve rezidenciale janë të ndara 200,000.00 euro dhe ato në kategorinë:

Paga dhe shtesa 100,000.00€

Mallra dhe shërbime 75,000.00€

Shpenzime komunale 10,000.00€

Shpenzime kapitale 15,000.00€

Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM)

Kërkesës së Komunave ju kanë përgjegjë Ministrinë e linjës për hapjen e shtëpive të reja për personat e moshuar, për personat me aftësi të kufizuara dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve në shumë prej 4.46 milion euro, do të financohet nga Granti i përgjithshëm, Për këtë qëllim komunës së Vushtrisë ju kanë ndarë 230,000.00€

Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2025 dhe parashikimet 2026- 2027

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2025 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë aprovuar në shumë prej 115 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale.

Në këto projeksione të të hyrave tatimore në pronë dhe tokë janë marrë parasysh parashikimet e pranuar nga departamenti i tatimit në pronë, ndërsa për projeksionet e të hyrave jo tatimore është marrë për bazë mesatarja e realizimit të të hyrave jo tatimore në tri vitet e fundit, parashikimet nga komunat mbi trendin e rritjes së të hyrave jo tatimore dhe realizimin e të hyrave jo tatimore.

Tabela e planifikimi i të hyrave vetanake 2025 – 2027

Komuna: Vushtri	THV - 2025	THV - 2026	THV - 2027
Buxhet dhe Financa	1,233,427.00	1,369,647.00	1,506,957.00
Taksat e firmave	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Tatimi në pronë	975,307.00	1,070,296.00	1,147,892.00
Tatimi në toka	243,120.00	284,351.00	344,065.00

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Inspektimet	14,000.00	15,000.00	13,000.00
Pranime teknike	8,000.00	8,500.00	6,000.00
Gjobat e inspektionit	6,000.00	6,500.00	7,000.00
Administrata	120,000.00	130,000.00	135,000.00
Shërbimet administrative	120,000.00	130,000.00	135,000.00
Urbanizmi	782,540.00	836,392.00	887,385.00
Lejet për ndërtim dhe konstruktime	632,540.00	670,392.00	710,885.00
Leje mjedisore	100,000.00	110,000.00	115,000.00
Legalizim	25,000.00	26,000.00	26,500.00
Shfrytëzimi i pronës publike	25,000.00	30,000.00	35,000.00
Gjeodezi dhe kadastrë	153,000.00	158,000.00	160,000.00
Hipoteka, RDDP, dalje në terren	100,000.00	100,000.00	100,000.00
Qiraja e pronave publike	53,000.00	58,000.00	60,000.00
Ekonomi dhe bujqësi	50,000.00	50,000.00	55,000.00
Ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore	50,000.00	50,000.00	55,000.00
Kulturë, rini, sport	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Palestra sportive	500.00	500.00	500.00
Bibliotekat	500.00	500	500
Shtëpia e kulturës	500.00	500	500
Shërbimet publike	999,000.00	1,037,500.00	1,085,127.00
Ndalja e veturave në rrugë	3,000.00	3,000.00	4,000.00
Taksat rrugore	150,000.00	152,000.00	155,000.00
Taksa për mbeturina	846,000.00	882,500.00	926,127.00
Totali i Administratës komunale	3,353,467.00	3,598,039.00	3,843,969.00
ARSIMI			
Çerdhet	70,000.00	72,000.00	73,000.00
Mësimi joformal SHMP "Bahri Haxha"	20,000.00	21,000.00	22,000.00
Mësimi joformal SHMT "Lutfi Musiqi"	20,000.00	22,000.00	24,500.00
Totali - Arsimi	110,000.00	115,000.00	119,500.00
TË ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA			
Shëndetësia primare	60,000.00	62,000.00	70,000.00
Shërbimet sociale	2,000.00	2,000.00	2,000.00
TOTALI SHËNDETËSI	62,000.00	64,000.00	72,000.00
TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNËS (I+II+III)	3,525,467.00	3,777,039.00	4,035,469.00

VI. Të hyrat komunale dhe parashikimi afatmesëm 2025-2027

Të hyrat e Komunës së Vushtrrisë nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare, si dhe të hyrat vetanake komunale.


	2024	2025	2026	2027	Ndryshimi 2024/2025	%
Gjitsejt grantet	23.351.884	24.367.259	25.454.423	26.568.674	1.015.411	4.35
Të hyrat vetanake	3.418.154	3.525.467	3.777.039	4.035.469	107.313	3.14

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Totali	26.770.038	27.892.762	29.231.462	30.604.143	3,639,694.00	4.19
---------------	------------	------------	------------	------------	--------------	-------------

Buxheti total i komunës në vite, milion euro:

Siç shihet në grafikon buxheti i ndarë për Komunën e Vushtrrisë për vitin 2025 ka shënuar një rritje në shumë prej 1,122,724.00€,



	Komuna Vushtrri	Grante dhe të hyra vetanake (HV) – 2024	Grante dhe të hyra vetanake – 2025	Grante dhe të hyra vetanake – 2026	Grante dhe të hyra vetanake – 2027
		në euro	në euro	në euro	në euro
	Burimet e të hyrave				
	Granti i përgjithshëm	10,497,156	11.343.396	12.004.613	12.677.887
	Granti për arsim	9,409,041	9.861.291	10.157.130	10.461.843
	Granti për shëndetësi	3,259,253	2.732.608	2.862.680	2.998.944

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

	Shërbimet rezidenciale	200,000	200,000	200.000	200.000
	Gjithsej grantet	23,595,450	24,137,295	25.224,423	26,338,647
	Të hyrat e bartura				
	Të hyrat e vitit aktual	3,418,154	3.525.467	3.777.039	4.035.469
	GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE	27,013,604	27.662,762	29.001.462	30,374,143

VII.Plani komunal i bashkëfinancimit sektorial me ministritë e linjës dhe donatorët

Komuna e Vushtrisë, me qëllim të financimit të projekteve me donatorë, ka lidhur marrëveshje bashkëpunim me ministritë e linjës për projektet e listuara në tabelën më poshtë.

	Përshkrimi i projektit	2024	2025	2026	TOTAL
	Projekti i rrugës R220 nga ura e Silnisës deri te Llamkos	52,700	100,000	100,000	252,700
	Rehabilitimi i rrugës Akrashticë Balinc	50,000	123,500		
	Rehabilitimi i rrugës nga maxhistrallja N2 Dumnicëe Ulët – Dumnicë e Poshtme	50,000			
	Rehabilitimi i rrugës “Dëshmorët Kombit”	50,000	53,300		
	Udha e Gurit	120,000	80,000		

Shpenzimet komunale sipas kategorive ekonomike për vitin 2025-2027

Me këtë dokument përcaktohen grantet qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025 dhe orientimet për vitet 2026-2027, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, ky dokument përcakton nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2025 si dhe parashikimin afatmesëm 2026-2027.

Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2025, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Për ndarjen e granteve qeveritare sipas komunave për vitin 2025 janë zbatuar kriteret dhe formulat bazë të përcaktuara në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe ligjet e tjera relevante, si dhe bazuar në projeksionet makro-fiskale dhe të dhënave nga ministritë e linjës:

Parimet mbi bazën e së cilës e kemi përgatitur buxhetin

Shpenzimet rrjedhëse: organizatat buxhetore duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha organizatat buxhetore t’u përmbahen kufijve të dhënë në Shtojcat e bashkangjitura.

Punësimi: Në parim nuk do të ketë rritje të punësimit në sektorin publik përveç kur ka një vendim të qartë për domosdoshmërinë e punësimeve të reja dhe kur është siguruar buxheti.

Pagat dhe shtesat: Gjatë këtij viti, paga mesatare në vend, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, shënoi trend rritës, me rreth 10.9%. Rritja ishte më e madhe në sektorin publik, si rezultat i implementimit të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik..


Mallra dhe shërbime: Kategoria e mallrave dhe shërbimeve pritet të ketë një rritje prej 2.4% Organizatave buxhetore do të mundësohet financimi në fushat e rëndësishme dhe të domosdoshme. Organizatat buxhetore duhet të identifikojnë burimet brenda skenarëve bazë të

tyre nga ato fusha me performancë jo të mirë, ose që nuk janë në përputhje të mjaftueshme me prioritetet e nivelit të lartë të Qeverisë.

Shpenzimet komunale: priten të ketë pjesëmarrje përafërsisht të njëjtë krahasuar me vitin 2024.

Subvencionet dhe transferet: subvencionet dhe transferet pritet të rriten mesatarisht me rreth 6.8%.

Shpenzimet kapitale: Investimet kapitale përbëjnë një pjesë konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe në periudhën afatmesme pritet që të përfaqësojnë rreth 25.7% të shpenzimeve totale. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritetesh që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor.



Shpenzimet komunale 2024 (këtë vit), të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	2024					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunali	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Zyra e Kryetarit	228,048	150,000		140,000		518,048
Zyra e Kuvendit komunal	222,748	15,000				237,748
Administrata dhe personeli	194,508	293,000			180,000	667,508
Inspektimet	151,187	20,000				171,187
Prokurimi	67,371	6,400				73,771
Buxhet dhe financa	187,674	31,000				218,674
Infrastrukturë publike	84,348	1,534,765	298,500	90,000	2,480,527	4,488,140
Zjarrfikësit dhe inspektimet	215,218	76,390	-	-	60,000	351,608
Menaxhimi i katastrofave	42,267	179,046	-	50,000		271,313
Zyra komunale për komunitete	54,891	11,000	20,000	3,000		88,891
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	104,512	25,200	-	250,000	300,000	679,712
Kadastrë dhe gjeodezia	92,797	8,000				100,797
Planifikimi urban dhe mjedisi	81,383	281,000	-	-	2,402,798	2,765,181
Shëndetësi	2,242,684	671,001	74,500	400,000	457,720	3,845,905
Administrata	41,752	3,500	-	150,000		195,252
Shërbimet e shëndetësisë primare	2,021,533	550,000	55,000	250,000	432,720	3,309,253
Shërbimet sociale	92,965	42,500	9,500	-	10,000	154,965
Shërbimet rezidenciale	86,434	75,001	10,000	-	15,000	186,435
Kulturë, rini dhe sport	215,472	54,000	-	150,000	300,000	719,472
Arsim dhe shkencë	8,569,884	1,484,198	178,000	140,000	1,200,000	11,572,082
Administrata	77,129	965,398	178,000	140,000		1,360,527
Arsimi parashkollor	448,982	92,094	-	-	200,000	741,076
Arsimi fillor	6,345,757	320,370	-	-	650,000	7,316,127
Arsimi i mesëm	1,698,017	106,136			350,000	2,154,353
GJITHSEJ	12,754,993	4,840,000	571,000	1,223,000	7,381,045	26,770,038

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	Stafi	2025					
		Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunal	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	23	220,000.00	200,000.00		320,000.00		740,000.00

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Zyra e Kuvendit komunal	26	260,000.00	10,000.00		-		270,000.00
Administrata dhe personeli	30	205,000.00	307,650.00		250,000.00	50,000.00	812,650.00
Inspektimet	15	140,000.00	34,440.00		-		174,440.00
Prokurimi	7	57,000.00	10,000.00		-		67,000.00
Buxhet dhe financa	27	195,000.00	45,000.00		-		240,000.00
Infrastrukturë publike	13	85,000.00	2,561,000.00	340,000.00	130,000.00	2,001,442.00	5,117,442.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	31	260,000.00	85,459.00	-	-	60,000.00	405,459.00
Menaxhimi i katastrofave	4	37,000.00	200,000.00	-	50,000.00		287,000.00
Zyra komunale për komunitete	9	58,000.00	11,550.00	35,000.00	5,000.00		109,550.00
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	14	85,000.00	30,000.00	-	400,000.00	1,400,000.00	1,915,000.00
Kadastrri dhe gjeodezia	13	90,000.00	8,400.00				98,400.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	9	89,000.00	350,000.00	-	-	1,465,000.00	1,904,000.00
Administrata	5	39,000.00	3,675.00	-	350,000.00		392,675.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	215	1,850,000.00	600,000.00	57,750.00	50,000.00	174,858.00	2,732,608.00
Shërbimet sociale	13	85,000.00	44,625.00	9,975.00	-		139,600.00
Shërbimet rezidenciale	11	100,000.00	75,000.00	10,000.00	-	15,000.00	200,000.00
Kulturë, rini dhe sport	31	226,000.00	56,700.00	-	150,000.00	150,000.00	582,700.00
Administrata	12	86,000.00	1,146,600.00	186,900.00	150,000.00		1,569,500.00
Arsimi parashkollor	67	460,000.00	96,698.00	-	-	80,000.00	636,698.00
Arsimi fillor	861	6,660,000.00	336,388.00	-	-	340,000.00	7,336,388.00
Arsimi i mesëm	200	1,720,000.00	111,652.00	-	-	100,000.00	1,931,652.00
GJITHSEJ	1,636	13,007,000.00	6,324,837.00	639,625.00	1,855,000.00	5,836,300.00	27,662,762.00

Projeksioni i shpenzimeve për vitin 2026, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	2026					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunali	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	231,000.00	210,000.00		352,000.00		793,000.00

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Zyra e Kuvendit komunal	273,000.00	10,500.00		-		283,500.00
Administrata dhe personeli	215,250.00	323,032.00		275,000.00	50,000.00	863,282.00
Inspektimet	147,000.00	36,162.00		-		183,162.00
Prokurimi	59,850.00	10,500.00		-		70,350.00
Buxhet dhe financa	204,750.00	47,250.00		-		252,000.00
Infrastrukturë publike	89,250.00	2,689,050.00	357,000.00	143,000.00	1,463,838.00	4,742,138.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	273,000.00	89,731.00	-	-	40,000.00	402,731.00
Menaxhimi i katastrofave	38,850.00	210,000.00	-	55,000.00		303,850.00
Zyra komunale për komunitete	60,900.00	12,127.00	36,750.00	5,500.00		115,277.00
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	89,250.00	31,500.00	-	440,000.00	1,000,000.00	1,560,750.00
Kadastrë dhe gjeodezia	94,500.00	8,820.00	-	-		103,320.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	93,450.00	367,500.00	-	-	1,937,285.00	2,398,235.00
Administrata	40,950.00	3,858.00	-	385,000.00		429,808.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	1,942,500.00	604,543.00	60,637.00	55,000.00	200,000.00	2,862,680.00
Shërbimet sociale	199,250.00	146,856.00	20,473.00	-	10,000.00	376,579.00
Shërbimet rezidenciale	100,000.00	75,000.00	10,000.00	-	15,000.00	200,000.00
Kulturë, rini dhe sport	237,300.00	59,535.00	-	165,000.00	300,000.00	761,835.00
Administrata	90,300.00	1,203,930.00	196,245.00	165,000.00		1,655,475.00
Arsimi parashkollor	483,000.00	101,532.00	-	-	100,000.00	684,532.00
Arsimi fillor	6,993,000.00	353,207.00	-	-	439,517.00	7,785,724.00
Arsimi i mesëm	1,806,000.00	117,234.00	-	-	250,000.00	2,173,234.00
GJITHSEJ	13,762,350.00	6,711,867.00	681,105.00	2,040,500.00	5,805,640.00	29,001,462.00

Projeksioni i shpenzimeve për vitin 2027, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

	2027					
	Paga/Mëditje	Mallra/Shërbime	Shpenzime komunal	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetarit	242,550.00	220,500.00	-	369,600.00		832,650.00

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Zyra e Kuvendit komunal	286,650.00	11,025.00	-	-		297,675.00
Administrata dhe personeli	226,012.00	339,183.00	-	288,750.00	180,000.00	1,033,945.00
Inspektimet	154,350.00	37,970.00	-	-		192,320.00
Prokurimi	62,842.00	11,025.00	-	-		73,867.00
Buxhet dhe financa	214,987.00	49,612.00	-	-		264,599.00
Infrastrukturë publike	93,712.00	2,823,501.00	374,850.00	150,150.00	1,720,000.00	5,162,213.00
Zjarrfikësit dhe inspektimet	286,650.00	94,217.00	-	-	60,000.00	440,867.00
Menaxhimi i katastrofave	40,792.00	220,500.00	-	57,750.00		319,042.00
Zyra komunale për komunitete	63,945.00	12,733.00	38,587.00	5,775.00		121,040.00
Bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural	93,712.00	33,075.00	-	462,000.00	1,000,000.00	1,588,787.00
Kadastrri dhe gjeodezia	99,225.00	9,261.00	-	-		108,486.00
Planifikimi urban dhe mjedisi	98,122.00	385,875.00	-	-	1,840,664.00	2,324,661.00
Administrata	42,997.00	4,050.00	-	404,250.00		451,297.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	2,039,625.00	637,520.00	63,669.00	55,000.00	203,130.00	2,998,944.00
Shërbimet sociale	193,712.00	179,198.00	10,996.00	-		383,906.00
Shërbimet rezidenciale	100,000.00	75,000.00	10,000.00	-	15,000.00	200,000.00
Kulturë, rini dhe sport	249,165.00	62,511.00	-	173,250.00	300,000.00	784,926.00
Administrata	94,815.00	1,264,126.00	206,057.00	173,250.00		1,738,248.00
Arsimi parashkollor	507,150.00	106,608.00	-	-	200,000.00	813,758.00
Arsimi fillor	7,342,650.00	370,867.00	-	-	350,000.00	8,063,517.00
Arsimi i mesëm	1,896,300.00	123,095.00	-	-	160,000.00	2,179,395.00
GJITHSEJ	14,429,963.00	7,071,452.00	704,159.00	2,139,775.00	6,028,794.00	30,374,143.00

INVESTIMET KAPITALE

Kategoria ekonomike investimet kapitale e prezantuar si kornizë më poshtë, paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të posaçme në aspektin e planifikimit për Komunën e Vushtrrisë. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme do të vazhdojë të jetë në funksion të

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes të sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Vushtrrisë në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

Projektet kapitale të komunës 2025-2027 dhe kostoja e asociuar me total në euro

Administrata			
Projekti	2025	2026	2027
Teknologji informative	15,000 €	15,000	15,000
Rregullimi i hapsirave në komunë	30,000	20,000	20,000
	45,000	35,000	35,000

Infrastruktura Publike			
Projekti	2025	2026	2027
Ndërtimi i kanalizimeve	550,000.00	500,000.00	450,000.00
Ndërtimi I rrugëve me kabëza betoni	330,000.00	300,000.00	280,000.00
Ndërtimi I trotuareve	100,000.00	80,000.00	70,000.00

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Ndërtimi ujësjellësit në pjesën lindore	900,000.00	700,000.00	700,000.00
Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	60,000.00	50,000.00	50,000.00
Rrugët e rendit IV	100,000.00	80,000.00	70,000.00
Rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara	200,000.00	300,000.00	285,000.00
Ndërtimi i urave	90,000.00	80,000.00	70,000.00
Blerja e veturave për administratën komunale - Vushtrri	40,000.00	20,000.00	20,000.00
Ndriçimi publik në Vushtrri,	30,000.00	20,000.00	25,000.00
	2,400,000.00	2,130,000.00	2,020,000.00

Bujqësia			
	Projekti - marrëveshjet	Shuma e kërkuar	Kohe e realizimit
1	Bashkëfinancim me donatorë	1,500,000.00	
2	Ibër Lepenc- pagesa 50% e shpenzimeve të ujitjes	50,000.00	
6	Subvencionimi i serrave-foli	20,000.00	
7	Trajtimi i argjinaturave të lumit silnica	300,000.00	
8	Trajtimi i lumenjve dhe argjinaturave	150,000.00	
		2,020,000.00	

Planifikimi Urban dhe Mjedisi				
Projekti	2025	2026	2027	
Ndërtimi i rr. Bekim Berisha-Abeja	750,000	100,000	400,000	Mbështetja në zhvillimin e qëndrueshëm ka për qëllim përmirësimin e cilësisë të jetës së qytetarëve të komunës, dhe brezave që do të vijnë.
Ndërtimi i rr. Lumni Surdulli	650,000	350,000	300,000	
Ndërtimi i rr. Avni Saraci	15,000	5000		

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

Ndërtimi i rr. 2 Maji	200,000	400,000	100,000	-Mbrotja e mjedisit; -Urbanizimi i qytetit; -Ndërtimi i shesheve;
Rikonstruimi i Bulevardit dhe Lidhja me parkun e Qytetit	685,000	800,000		
Projekte të reja		952,650	1,997,000	
Ndërtim i rrugëve lokale	200,000	800,000	1,000,000	
TOTALI	2,500,000	3,058,000	3,797,000	

Prioritetet strategjike

Në sektorin e shëndetësisë synohet përmirësimi i shëndetit të popullatës nëpërmjet promovimit të mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe sigurimit të shërbimeve cilësore shëndetësore me qasje të lehtë dhe të barabartë dhe me kosto të përballueshme.

	Përshkrimi i Projekteve	VLERA në €
1	Rregullimi i sportelit në QMF-Pantine dhe QKMF objetin e ri	7,000

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

2	Rehabilitimi dhe izolimi i rrengit dhe ventilimi për objektin e ri të QKMF-së	60,000
3	Blerja dhe furnizimi me pajisje mjekesore	60,000
4	Aparat për hequrje rre, dhe pajisje tjera	16,000
5	Furnizimi dhe montimi i kalldasë Qiler në objektin e QMF-1, dhe instalimi i sistemit për ngrohje dhe ftohje	77,720
6	Kombi për transportin e pacientëve të hemodializes	39,000
7	Renovimi i objekteve shëndetësore dhe rrethojave, QKMF, QMF dhe AMF	70,000
8	Blerja dhe furnizimi me inventar	20,000
9	Furnizimi me Inventor	10,000
10	Furnizimi me pajisje teknike	5,000
11	Blerja, furnizimi dhe montimi i kamerave	10,000
12	Klima për objekte shëndetësore	10,000
13	Teknologji informative	20,000
14	Automjet Terreni (vizita shtëpiake)	28,000
	TOTALI:	432,720

Projektet e propozuara					
Kultura, rinia dhe Sportet					
Nr.	Projektet	Shuma € 2025 (vitin e 1)	Shuma € 2026 (vitin e 2)	Shuma € 2027 (vitin e 3)	Prioritetet strategjike
1.	Mini bibliotekat e qasshme në qytet	20.000	10.000		Zhvillimi i turizmit kulturor, rural dhe sportiv
2.	Renovimi i stadiumit “Ferki Aliu”	150.000	15.000		
3.	Bech voleyball	80.000	50.000		
4.	Inventarizimi i Qendrës rinore	10.000			
5.	Renovimi i muzeut	12.000	5.000		
6.	Dixhitalizimi i bibliotekës	100,000	70.000	30,000	
	TOTALI	372,000			

Arsimi			
Projekti	2025	2026	2027
Ndërtimi I shkollave	700,000.00	600,000.00	600,000.00
Meremetim I shkollave	170,000.00	110,000.00	120,000.00
Teknologji informative	130,000.00	140,000.00	140,000.00
Rregullimi I ngrohjeve qendrore	70,000.00	40,000.00	40,000.00
Fusha sportive	60,000.00	60,000.00	60,000.00
Objekte ndihmese	30,000.00	30,000.00	30,000.00
Rrethoja	60,000.00	60,000.00	60,000.00
Rregullimi I oborreve	50,000.00	50,000.00	50,000.00
Kabinete për shkolla	100,000.00	70,000.00	70,000.00
Inventar	100,000.00	100,000.00	100,000.00
	1,470,000.00	1,260,000.00	1,270,000.00

II. Analiza gjinore

Buxhetimi i përgjithshëm gjinor tashmë është pjesë e kornizave legjislative të vendit e cila kërkon nga të gjitha institucionet publike, të integrojnë barazinë gjinore në projektimin e politikave zhvillimore dhe në shpenzimin e parasë publike. Buxhetimi i përgjithshëm gjinor pranon se gratë dhe burrat kanë marrëdhënie të ndryshme me ekonominë. Po ashtu, kjo ka të bëjë edhe me faktin se nëse duam të arrijmë progres të qenësishëm për barazinë gjinore, politikat pa buxhet nuk

KAB 2025-2027 bëhet përfundimtar pas miratimit të buxhetit në Kuvendin Komunal

mjaftojnë. Buxheti i përgjithshëm gjinor kërkon që buxhetet t'u përgjigjen më mirë nevojave të njerëzve. Qëllimi është të integrohet aspekti gjinor si një kategori, analizë dhe kontroll në procesin buxhetor. Logjika mbi të cilën mbështetet buxheti i përgjithshëm gjinor është se si të gjitha politikat shtetërore buxheti i prek ndryshëm gratë dhe burrat për shkak të nevojave dhe roleve të tyre mbi baza gjinore. Synimi i buxhetimit të përgjithshëm gjinor është:

- Të sigurojë që masat e buxhetit të shtetit (si nga ana e shpenzimeve ashtu edhe nga ana e të ardhurave të buxhetit) të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave, burrave, të vajzave dhe djemve;

- të sigurojë që buxheti kontribuon në zvogëlimin e pabarazisë gjinore; dhe

- të realizojë shërbime publike në mënyrë që të rritet barazia gjinore.

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjithshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar sesi shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës dhe e kemi paraqitur këtë informacion në tabelat e mëposhtme:

Tabela 11:

Kategoria	Shifrat sipas regjistrimit të popullsisë 2011	%	Parashikimi për vitin 2025(varianti i mesëm)	%
Gra	17,541	25.11	18,583	25.54
Burra	15,891	22.74	16,366	22.49
Vajza	16,325	23.36	17,220	23.67
Djem	20,113	28.79	20,593	28.30
Popullata e përgjithshme	69,870	100	72,762	100

IX. Informacionet sipas programeve

Zyra e Kryetarit

Misioni: Misioni është që kjo zyrë të jetë e përgjegjshme dhe llogaridhënëse për të arritur rezultatet që avancojnë interesat e qytetarëve.

Vizioni: Ofrimi i këshillave për Kryetarin e komunës, gjegjësisht ekzekutivin e komunës

Duke ditur se posti i Kryetarit të komunës, përkatësisht qeverisë komunale kërkon angazhim dhe përgjegjësi të veçantë për t'u ballafaquar me probleme të ndryshme, si dhe duke pas parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike dhe sociale në komunën tonë, vizioni ynë është që organet e komunës t'i kryejnë obligimet e tyre dhe përgjegjësitë në pajtim me ligjet, rregulloret, vendimet e kuvendit dhe aktet tjera në fuqi, gjegjësisht për angazhim të shtuar dhe efektshmëri sa më të madhe në punë, si dhe për ofrim të shërbimeve sa më cilësore të qytetarëve, për një jetë më të mirë, perspektivë dhe prosperitet në të ardhmen.

Zyra e Kuvendit

Misioni: Për t'i shërbyer qytetarët e komunës, duke siguruar procedim me kohë për miratimin e duhur të propozimeve nga Kryetari i komunës, respektivisht qeverisë komunale, në kuvendin e komunës në përputhje me detyrimet ligjore.

Vizioni: Për të siguruar shqyrtimin në afat ligjor dhe miratimin e politikave të komunës, duke përfshirë edhe legjislacionin brenda kompetencave ligjore të komunës, siç janë: Statuti i komunës, rregulloret komunale, planifikimi buxhetor etj. e gjithë kjo në interes të qytetarëve të Komunës së Vushtrisë.

Shërbimet publike, mbrojtja civile dhe emergjencat

Misioni: Një komunë e pastër dhe e sigurt për të gjithë qytetarët.

Vizioni: Për të përmbushur obligimet statutores të drejtorisë dhe adresimin e nevojave të qytetarëve tanë në fushën e rrjetit komunal rrugor, ujit dhe infrastrukturës së mbeturinave, hapësirave të gjelbra, shërbimeve emergjente dhe të sigurisë. Ne do të bëjmë dhe arrijmë këtë duke zbatuar mirëmbajtjen e planifikuar dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve, hapësirave publike (duke përfshirë parqet dhe varrezat), furnizimin me ujë dhe menaxhimin e ujërave të ndotura. Ne gjithashtu do të sigurojmë një plan të duhur që është në vend dhe zbatohet për mbrojtjen nga zjarri dhe emergjencat tjera.

Shëndetësia dhe mirëqenia sociale.

Misioni: Një komunë ku popullata ka qasje më të përbalueshme dhe efektive në shërbimin e kujdesit parësor shëndetësor, mbrojtjes dhe asistencës sociale.

Vizioni: Në drejtorinë tonë ne punojmë për të zbatuar legjislacionin përkatës shëndetësor, për të siguruar që shërbimet e mëposhtme primare shëndetësore për të gjithë qytetarët ofrohen në fushat e mjekësisë familjare, stomatologjisë, farmacisë, shërbimet laboratorike dhe kujdesin mjekësor emergjent. Ne i ofrojmë këto shërbime duke punësuar staf profesional dhe duke e trajnuar stafin mjekësor që vepron në Qendrën kryesore të mjekësisë familjare . Përveç kësaj, ne po ashtu do të punojmë për të siguruar nivelet e duhura të higjienës që nga kryerja e inspektimeve sanitare për ujin e pijshëm, bizneset prodhuese, përpunimin ose shitjen e ushqimit dhe atyre kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave. Gjithashtu synojmë për të siguruar mbështetje të shërbimit social në pikat më të rrezikuara të bashkësisë sonë dhe këtë e bëjmë përmes identifikimit të rasteve sociale, dhe duke vlerësuar nevojën rast për rast.

Indikatori	2022	2023	2024
% e fëmijëve nën moshën 1 vjeçare që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit	95%	96%	98%
Renovimi i objekteve shëndetësore; % e zbatimit të planit 3 vjeçar për përmirësimin e objekteve shëndetësore	100%	100%	100%
Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve	1 doktor në 2500 banorë	1 doktor në 2300 banorë	1 doktor në 2000 banorë
Numri i fëmijëve shkollor që kryejnë kontrolle dentare përmes vizitave në shkolla, vetëm gjatë kontrolleve sistematike të klasave të para që kryhen çdo vit.	1070 nxënës	1100 nxënës	1200 nxënës
Numri i shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijësimin dentar, vetëm gjatë kontrolleve sistematike të klasave të para që kryhen çdo vit	1070 nxënës	1100 nxënës	1200 nxënës

Planifikimi Urban dhe Mjedisit

Misioni: Mjedis më tërheqës natyror dhe përdorim më efektiv i tokës dhe ndërtesave në Kosovë.

Vizioni: Planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik, përcjell dhe studion zhvillimin hapësinor brenda territorit të komunës (sipas metodologjisë bashkëkohore);

- Harton Planin Zhvillimor të Komunës, Harten Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme;
- Ofron sugjerime dhe mendime lidhur me procedurën për miratimin e tyre dhe propozon realizimin e tyre;
- Mbledh, përpunon dhe plotëson dokumentacionin e zhvillimit hapësinor, në harmoni me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe dispozitat tjera të nxjerra në bazë të tij; Ligjit për Ndërtim dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë fushën e ndërtimit dhe planifikimit .
- Bashkëpunon me të gjitha subjektet pjesëmarrëse në planifikimin dhe zhvillimin e qytetit dhe të komunës për hartimin e planeve hapësinore;
- Merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës;

- Bashkëpunon rreth konceptit të zgjidhjeve dhe përmbajtjeve të planeve rregulluese urbane;
- Përcjell planifikimin urbanistik dhe projektimin si dhe merret me zbatimin e tyre;
- Përgatit plane të detajuara urbanistike, projektet urbanistiko-arkitektonike për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit dhe komunës;
- Harton programe, detyra projektuese me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur për organizimin e konkurseve urbanistiko-arkitektonike në nivel vendor dhe ndërkombëtar;
- Përgatit dhe ofron informacione bazë dhe dokumente për përgatitjen, miratimin apo ndryshimin e planeve hapësinore, urbanistike, rregulluese dhe planeve të detajuara të qytetit dhe të komunës;
- Propozon dhe miraton kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme, pajisjeve dhe elementeve mikro-urbane në territorin e qytetit dhe komunës;
- Merret me hartimin e legjislacionit, ekspertizave analitike, veprimtarive të tjera në fushat e caktuara të planifikimit hapësinor dhe urban;
- Propozon dhe zbaton programin për hapësirën e komunës;
- Jep pëlqime për ndërtimin e objekteve të rëndësisë lokale dhe zhvillimeve të tjera;
- Organizon dhe kontrollon dokumentacionin teknik;
- Organizon dhe cakton grupin profesional për mbikëqyrje, pranime teknike të objekteve ndërtimore dhe shërbime tjera përkatëse;
- Lëshon vendime dhe vërtetime për gjendjen e objekteve ekzistuese;
- Konstaton dhe delegon informatat për objektet e ndërtuara në mospërputhje me ligjet ndërtimore, standardet dhe dokumentacionet urbanistike në fuqi;
- Jep leje për përdorimin e objekteve të përfunduara;
- Inicon programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në territorin e komunës;
- Bashkëpunon me subjektet përkatëse komunale në fushën e rregullimit të tokës ndërtimore;
- Propozon krijimin e zonave të tokës së ndërtimit dhe përpunon lokacionet për dhënien e tokës në shfrytëzim;
- Zbaton programet e sektorëve të tjerë të Administratës komunale, në fushën e ndërtimit të infrastrukturës dhe objekteve kapitale, si dhe vendimet komunale nga përgjegjësia e kësaj drejtorie;
- Përgatit propozimet e Rregulloreve dhe akteve tjera nga lëmi i ndërtimit, planifikimit, projektimit dhe rregullimit hapësinor;
- Udhëzon dhe orienton subjektet nga fusha e ndërtimit, bashkëpunon me subjektet udhëheqëse dhe personat juridikë nga fusha e ndërtimit, ofron të dhënat dhe informata të tjera bazike profesionale të nevojshme për punën e udhëheqjes komunale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimit;
- Kryen detyra të tjera të deleguara nga ligji dhe rregulloret tjera në fuqi;
- Harton projektprogramin për vlerësimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Propozon dhe zbaton programin e veçantë për rregullimin e gjendjes ekzistuese të tokës ndërtimore të komunës;
- Organizon dhe trajnon grupet profesionale dhe kapacitetet njerëzore për procedurën e legalizimit.
- Organizon dhe cakton grupin profesional për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave (dokumentacioneve) për legalizim;
- Kontrollon dokumentacionin teknik në harmoni me ligjet ndërtimore, standardet, dokumentacionet urbanistike në fuqi, si dhe me rregulloren dhe manualin për legalizim;
- Shqyrton programe për ndërtimin e infrastrukturës dhe objekteve kapitale në tërësitë hapësinore ilegale;
- Koordinon dhe kryen punët procedurale nga lëmi i ndërtimeve ilegale;
- Kryen edhe detyra të tjera në pajtim me dispozitat ligjore.

Indikatori	2022	2023	2024
Koha për lëshimin e lejes ndërtimore	30-45	30-45	30-45
% e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjor	70	80	85

Bujqësi, pylltari dhe zhvillimi rural

Misioni: Për të krijuar ambient tërheqës, bashkësi familjare ekonomikisht të qëndrueshme në zonat rurale, duke përfshirë të gjitha grupet pa dallim etniteti, feje apo gjinie për një ambient të qëndrueshëm socio-ekonomik dhe duke promovuar praktikatat e mira bujqësore.

Vizioni: Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe ta bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore përmes mbajtjes së një shënimi/të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët dhe për të stimuluar dhe promovuar blerjet blegtorale dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu bashkëpunojmë ngusht me ekspertë të IADK që të ofrojmë këshilla për fermerë për të zhvilluar kapacitetet prodhuese, ngritjen e fuqisë së tyre konkurruese në treg, duke promovuar praktikatat më të mira bujqësore. Ne do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

Indikatori	2022	2023	2024
% e tokës bujqësore që është duke u kultivuar	caku për vitin 2022	caku për vitin 2023	caku për vitin 2024
5986 ha	6083 ha	6154 ha	6250 ha

Arsimi dhe Shkenca

Misioni: Çdo personi do duhet t'i mundësohet arsimi, sporti dhe kultura nëpërmjet përvojave të të nxënësve pozitiv dhe do të stimulohet për arritjet e tij / saj të plota, veprime të cilat do ju japin atyre besim dhe do të gjejnë vet përmbushje me atë që merren.

Vizioni: Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të mëtejshëm për të rriturit dhe për ta bërë këtë kemi siguruar zbatimin e

rregullores kombëtare, legjislacionin e duhur arsimor dhe politikat gjegjëse si rezultat. Po ashtu marrim pjesë në përzgjedhjen e stafit dhe drejtorëve të shkollave për të siguruar se profesionistët dhe të kualifikuarit janë të punësuar për të mësuar qytetarët tanë, të rinjtë dhe të moshuarit dhe njëherit i mbajmë të gjitha shënimet e nevojshme komunale të arsimit dhe statistikave për të matur nivelin e cilësisë së arsimit që ofrohet nga komuna. Gjithashtu komunikojmë hapur me publikun për të gjitha çështjet që lidhen me politikën e arsimit dhe të procesit përbrenda komunës, si dhe bëjmë promovimin e sportit dhe kulturës me organizimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore, përkrahjen e organizatave sportive dhe drejtimin e qendrës komunale të kulturës.

Indikatori	2023	2024	2025
% e fëmijëve që arrijnë moshën për të filluar shkollën	8 %	7.93 %	7.91%
% e nxënësve që kalojnë provimin shtetëror	53.95 %	54.33%	55.05%
% e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime	100 %	100 %	100 %
Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm.	Niveli o, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli o, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17	Niveli o, 1:17.4 Niv. 1 dhe 2 1:16% Niveli 3, 1:17

Administrata dhe Personelit

Administrata dhe Personeli

Misioni: Drejtoria e Administratës ka si mision ofrimin e të gjitha shërbimeve që janë në kompetencë dhe që mund të kryhen në këtë drejtori. Është një trend i ngritjes së vazhdueshme të efikasitetit dhe i ofrimit të shërbimeve sa më cilësore dhe më efektive, në mënyrë që t'i plotësojmë

dhe t'u përgjigjemi kërkesave të qytetarëve të Vushtrrisë dhe të gjithë palëve të interesuara të cilët i janë drejtuar komunës së Vushtrrisë

Vizioni: Ne përpiqemi të jemi një Komunë dinamike që përcakton trendet, duke ofruar shërbime cilësore të përgjegjshme ndaj kërkesave dhe sfidave të komunitetit dhe mandatit tonë kushtetues, në të cilin të gjithë palët e interesuara mund të marrin pjesë në harmoni dhe dinjitet.

Përmes shërbimeve që i ofrojmë si Drejtori dhe shërbimeve të tjera të cilat pretendojmë t'i vëmë në funksion, përpiqemi t'ua bëjmë sa më të lehtë qasjen në shërbimet tona qytetarëve, si dhe funksionimin sa më efektiv dhe eficient nga ana jonë.

Vizioni ynë si drejtori është që me punën dhe profesionalizmin tonë t'ua lehtësojmë marrjen e shërbimeve qytetareve, si dhe të jemi transparent e llogaridhënës në punën tonë.

Indikatori	2021	2022	2023
Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile	60,000	60,000	60,000
Numri i kërkesave të pranuar nga QSHQ	70,000	70,000	70,000

Buxheti dhe financat

Misioni: Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e fondeve komunale.

Vizioni: Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët e Vushtrrisë. Ne mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloret tjera përkatëse. Ky veprim përfshin zbatimin e rregullores mbi tarifat dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu do i përgatitim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutorë komunale.